

**L I G J**  
**Nr.9485, datë 6.3.2006**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË AMENDAMENTIN E  
MONTREALIT TË PROTOKOLLIT TË MONTREALIT “PËR SUBSTANCAT QË  
HOLLOJNË SHTRRESËN E OZONIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në amendamentin e Montrealit të Protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4808, datë 20.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë  
Alfred Moisiu**

**AMENDAMENT I PROTOKOLLIT**  
**TË MONTREALIT PËR SUBSTANCAT QË HOLLOJNË SHTRRESËN E OZONIT,**  
**MIRATUAR NGA TAKIMI I NËNTË I PALËVE**

Neni 1

**Amendamenti**

A. Neni 4, paragrafi 1 qua

Paragrafi i mëposhtëm do të futet pas paragrafit 1 ter të nenit 4 të protokollit:

1 qua. Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij paragrafi, çdo palë do të ndalojë importin e substancës së kontrolluar në aneksin E nga shtete që nuk janë palë të këtij protokollit.

B. Neni 4, paragrafi 2 qua

Paragrafi i mëposhtëm do të futet pas paragrafit 2 ter të nenit 4 të protokollit:

2 qua. Duke filluar nga një vit pas datës së hyrjes në fuqi të këtij paragrafi, çdo palë do të ndalojë eksportin e substancës së kontrolluar në aneksin E në çdo shtet që nuk është palë e këtij protokollit.

C. Neni 4, paragrafët 5, 6 dhe 7

Në paragrafët 5, 6 dhe 7 të nenit 4 të protokollit, për fjalët:

Dhe grupi II i aneksit C

Atje do të zëvendësohen:  
Grupi II të aneksit C dhe aneksin E

D. Neni 4, paragrafi 8  
Në paragrafin 8 të nenit 4 të protokollit, për fjalët:  
Neni 2G  
Do të zëvendësohen me:  
Nenet 2G dhe 2H

E. Neni 4A: Kontrolli i tregtisë me palët  
Neni i mëposhtëm do t'i shtohet protokollit si neni 4A:

1. Në rastet kur pas kalimit të datës së aplikueshme për një substancë të kontrolluar, një palë është në gjendje, megjithëse ka marrë të gjitha hapat praktike për të përmbushur detyrimet e protokollit, të ndalojë prodhimin e kësaj substance për konsum vendas, me përjashtim të përdorimeve të tjera të rena dakord nga palët që janë thelbësore, ajo do të ndalojë eksportin e sasive të përdorura, ricikluara dhe rikuperuara të kësaj substance, për qëllime të tjera përveç shkatërrimit.

2. Paragrafi 1 i këtij neni do të aplikohet pa paragjykime për veprimin e nenit 11 të Konventës dhe procedurat e moszbatimit zhvilluar nën nenin 8 të këtij protokollit.

F. Neni 4B: Licencimi

Neni i mëposhtëm do t'i shtohet protokollit si neni 4B:

1. Çdo Palë, që nga 1 janari 2000 ose brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij neni, cilado nga këto data që është e mëvonshme, do të vendosë dhe do të zbatojë një sistem për licencimin e importit dhe eksportit të substancave të reja, ricikluara ose rikuperuara në anekset A, B, C dhe E.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, çdo palë që vepron nën paragrafin 1 të nenit 5, e cila vendos që nuk është në gjendje të vendosë dhe të zbatojë një sistem për licencimin e importit dhe eksportit të substancave të kontrolluara në anekset C dhe E, mund ta shtyjë marrjen e këtyre vendimeve, respektivisht, deri në 1 janar 2005 dhe 1 janar 2002.

3. Çdo palë, brenda tre muajve nga data e futjes së sistemit të licencimit, do t'i raportojë sekretariatit mbi vendosjen e këtij sistemi.

4. Sekretariati, periodikisht, do të përgatisë dhe do të qarkullojë në të gjitha palët, një listë të të gjitha palëve që kanë raportuar për sistemin e licencimit dhe do t'ia kalojë këtë informacion Komitetit të Implementimit për vlerësim dhe rekomandime për palët.

Neni 2

### **Lidhja me amendamentin e vitit 1992**

Asnjë shtet ose organizatë për integrim ekonomik rajonal nuk mund të depozitohet një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi me këtë amendament në rast se, më parë ose në të njëjtën kohë, nuk ka depozituar një instrument të tillë për amendamentin e miratuar në takimin e katërt të palëve në Kopenhagen më 25 nëntor 1992.

Neni 3

### **Hyrja në fuqi**

1. Ky amendament do të hyjë në fuqi më 1 janar 1999, në rast se të paktën njëzet instrumente ratifikimi, pranimi ose miratimi të këtij amendamenti janë depozituar nga shtetet ose organizatat ekonomike për integrim rajonal që janë palë të protokollit të Montrealit për substancat që hollojnë shtresën e ozonit. Në rast se ky kusht nuk është përmbushur deri në atë datë, amendamenti do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën është plotësuar.

2. Për qëllime të paragrafit 1, çdo instrument i tillë i depozituar nga një organizatë rajonale për integrim ekonomik nuk do të konsiderohet si shtesë e atyre të depozituara nga shtetet anëtare të këtyre organizatave.

3. Pas hyrjes në fuqi të këtij amendamenti, siç jepet në paragrafin 1, ai hyn në fuqi për të gjitha

palët e tjera të protokollit në ditën e nëntëdhjetë të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit.